



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:301612

Datë: 13.11.2024

Numri i dokumentit: 06446797

C.nr.3667/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve H.A dhe Xh.A, nga V të cilën e përfaqëson N.B., avokat me seli në V, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i diferencës në pension për shkak të inflacionit, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seance, me datë 11.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, SHPALLET JO KOMPETENTE në pikëpamje lëndore dhe HUDHET POSHTË SI E PALEJUAR, padia e paditësve H.A dhe Xh.A C.nr.3667/24 e datës 14.06.2024, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me objekt kontesti kompensim i diferencës në pension për shkak të inflacionit.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuarit të tij, me datë 14.06.2024, kanë parashtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit H.A, në emër të kompensimit të diferencës në pension për shkak të inflacionit, për periudhën nga data 01.01.2021 e deri me datë 31.05.2024, t'ia paguaj shumën prej 255.30 euro, si dhe paditëses Xh.A në emër të kompensimit të diferencës në pension për shkak të inflacionit, për periudhën nga data 01.01.2021 e deri me datë 31.05.2024, t'ia paguaj shumën prej 255.30 euro me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare,

si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 177.00 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjyqimit e nën kërcënimin e përmbarimit.

Gjykata, pasi bëri shqyrtimin paraprak të padisë dhe shkresave të lëndës, gjeti se çështja e cila është objekt i kësaj padie, përbën çështje administrative, për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen sipas kërkesëpadisë së paditësit është kompetent Organi administrativ, konkretisht Departamenti përkatës për pensione në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe kjo për arsyet si më poshtë.

Sipas Ligjit 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, me nenin 13 është përcaktuar se *“Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave, me vendim të veçantë, do të vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve të përcaktuara me këtë ligj.”*. Ndërsa me nenin 14 par. 4 pika e të njëjtit ligj përcakton se *“Ministria e Financave, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 2002/1 mbi metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensionit bazë në Kosovë, do të jetë përgjegjëse për llogaritjet që kërkohen nga ky ligj dhe për përcaktimin e nivelit të rritjes së pagesave të pensioneve të përcaktuara me këtë ligj.* Tutje, neni 18 par. 1 i të njëjtit Ligj përcakton se *“Departamenti përkatës për pensione i Ministrisë, është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj.* Kurse me nenin 19 par. 1 të këtij Ligji përcaktohet se *“Të drejtën në pension parashtruesi i kërkesës e realizon përmes parashtrimit të kërkesës në Ministri.”*

Tutje me Ligjin nr. 08/l-176 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e tyre me Ligjin Nr. 05/l-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me kapitullin XVII është bërë Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit Nr. 04/l-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, ku në nenin 62 përcaktohet se *Neni 19 i Ligjit bazik ndryshohet si dhe pas nenit 19 shtohen edhe dy nene të reja, 19A dhe 19B si në vijim: Neni 19 Parashtrimi i kërkesës “Të drejtën në pension parashtruesi i kërkesës e realizon përmes parashtrimit të kërkesës në Ministri. Mënyra dhe forma e parashtrimit të kërkesës bëhet në pajtim me dispozitat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Neni 19A Afati për marrjen e vendimit Procedura administrative e filluar sipas kërkesës sipas nenit 19 përfundohet brenda afatit prej dyzet e pesë (45) ditësh. Neni 19B E drejta e ankesës 1. Kundër secilit vendim përfundimtar të nxjerr sipas Ligjit bazik lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative. 2. Kundër vendimeve të lëshuara në procedurë të inspektimit sipas këtij Ligji*

lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative. 3. Organ epror që shqyrton ankesat sipas këtij neni është Komisioni i ankesave i themeluar me vendim të Ministrit të Ministrinë përgjegjëse për punë dhe mirëqenie sociale. Ministri përkatës me Akt nënligjor përcakton përbërjen e komisionit dhe mandatin e anëtarëve të komisionit, i cili nxjerrët tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji. Puna dhe procedura e komisionit të ankesave bazohet në rregullat e përcaktuara për organet kolegjiale në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në kuptim të dispozitave të cituara më lartë, kjo gjykatë vlerëson çështja e pensioneve është procedurë për të cilën ka kompetencë organi administrativ, përkatësisht e Departamentit përkatës për pensione i cili funksionon në kuadër të Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe në kuptim, legjislacioni pozitiv i Kosovës ka ofruar mbrojtje ligjore duke përcaktuar procedurat që duhet ndjekur lidhur me kërkesat e pensionistëve për çështjet e pensioneve, mirëpo kërkesat e tilla duhet drejtuar organeve administrative e jo që realizimi i këtyre kërkesave të kërkohet përmes procedurës kontestimore të kësaj gjykate.

Në anën tjetër, me nenin 18 par.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, përcaktohet se “*Kur gjykata gjatë procedimit të çështjes konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata veçse ndonjë organ shtetëror tjetër, do të shpallet inkompetente, do t’i shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur*”.

Prandaj pasi kërkesa e paditësve nuk mund të realizohet në procedurë kontestimore, për faktin se lidhur me kontestin e natyrës të ngritur me padi, gjykatës i mungon kompetenca gjyqësore për vendosje, gjykata duke u bazuar në nenin 391 pika a) ku thuhet se “*Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: a) çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore*”, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me të cilën kjo gjykatë është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për trajtimin e kësaj çështje dhe e ka hedhur padinë e paditëseve.

Andaj, nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.3667/24, me datë 11.11.2024

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.